

VENDIM
Nr. 241, datë 30.4.2025

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIM DEPO NË ZONËN E KATUNDIT TË RI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim depo në zonën e Katundit të Ri”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Ujësjetllës-Kanalizimeve Tiranë sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë” dhe “pemëtores”, me një vlerë të përgjithshme prej 595 006.72 (pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e dy) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 595 006. 72 (pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e dy) lekësh, përballohet nga Ujësjetllës-Kanalizimet Tiranë sh.a.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Ujësjetllës-Kanalizimet Tiranë sh.a.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Ujësjetllës-Kanalizimeve Tiranë sh.a.

8. Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë sh.a. kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Ujësjetllës-Kanalizimet Tiranë sh.a.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për Ujësjetllës-Kanalizimet Tiranë sh.a., sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Tiranë për Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë sh.a., sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2, Bashkia Tiranë, Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë sh.a. dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIM DEPO NË ZONËN E KATUNDIT TË RI”

Nr.	Pronari	Të dhënat kadastrale (sipas kartelës për shpronësim)					Vlerësimet për shpronësim				Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
							Arë/pemëtore			Vlera totale (lekë)	
		Emri, atësia, mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	
1	Martin Fejzulla Elezi Fatlinda Fatmir Elezi	2119	225/170	Arë	900	12	43	826.80	448.00	370,406.40	370,406.40
3	Flutur Shaqir Kryeziu Liljana Nexhmi Pajo Kujtime Shaqir Shehi Arta Asllan Osmani Dritan Shaqir Peza Lavdie Shaqir Peza Dallendyshe Shaqir Idrizi	2119	225/92/38	Pemëtore	2000	13	26	497.20	448.00	222,745.60	222,745.60
4	Arjan Jaçe Bersha Aleko Teme Lama	2119	255/92/36	Pemëtore	1000	11	212	4.14	448.00	1,854.72	1,854.72
	Vlera totale								595,006.72	595,006.72	